



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.589/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj, kryesuese dhe Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa Anr.589/2025, e datës 15.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 15.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se me datën 14.02.2025 në kutinë nga vendvotimi nr. 1929/04 (SHFMU "7 Marsi" Emshir në Prishtinë) numëruesit në QKN në Sallën 1 Tetori, komisionarët gjatë numërimit kanë shpallur të pavlefshme dy (2) fletëvotime - vota, një (1) të subjektit politik LDK dhe një (1) të LVV-së. Parashtruesi i ankesës konsideron se sipas doracakut të KQZ-së vota e LDK-së është e vlefshme sepse

qëllimi i votuesit në rastin konkret shihet qartë ngase epiqendra e vendosjes së shenjës së votimit është brenda kornizës së numrit 124 që është numri i LDK-së. Andaj e njëjta kërkon që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe kutia të shkoj në rinumërim. Si dëshmi ka bashkangjitur fletëvotimin e kontestuar.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja theksohet se bazuar në nenin 16 paragrafi 2 Rregullore Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit: në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik;

Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur:

1. Kur votohet më shumë se një subjekt politik;
2. kur nuk votohet asnjë subjekt politik;
3. kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik;
4. kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim

Gjithashtu, Paneli vlerëson se bazuar në nenin 16 paragrafi 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë vëren se ankesa është e pa bazuar.

Pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LDK me të cilën pretendon se gjatë numërimit të votave komisionarët kanë shpallur të pavlefshme një fletëvotim - votë, të subjektit politik LDK, paneli vlerësoi se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara këto pretendime. Në foton e bashkangjitur si provë në ankesë shihet një fletëvotim në të cilën është shënjuar me një vijë të pjerrtë në mes të subjektit politik LDK me numër 124 dhe subjektit politik PAI me numër 123, andaj nga kjo foto shihet se ky fletëvotim është i pavlefshëm pasi që nuk mund të konsiderohet se është votuar subjekti politik LDK për të

cilën pretendon pala me ankesë, sikurse që nuk mund te konsiderohet se është votuar as subjekti politik PAI.


Neni 16 paragrafi 2 Rregullore Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës përcakton se “vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit” Ndërsa vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: Kur votohet më shumë se një subjekt politik; kur nuk votohet asnjë subjekt politik; kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e tij pasi që nga provat e ofruara si dëshmi shihet qartë se fletëvotimi në fjalë nuk është i plotësuar sipas rregullave të votimit si dhe sipas dispozitave të sipërcituara dhe mbi këtë bazë ky fletëvotim duhet të shpallet i pavlefshëm.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuar në ligj, andaj ankesa u refuzua e pa bazuar në kuptim të nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.589/2025, datë 18.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.